

PROJEKTI

“Forcimi i Transparencës së Zgjedhjeve në Shqipëri”

RAPORT MONITORIMI

Nr. 1

**mbi kufizimet e përdorimit të burimeve
shtetërore në fushatën zgjedhore**

Periudha 25 dhjetor 2020 – 15 janar 2021

Hartoi raportin:

Isuf Shehu - Gerta Meta

Ky projekt mbështetet nga ambasada e Mbretërisë së Holandës në Tiranë dhe programi i përbashkët i Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian “Aksioni kundër Krimit Ekonomik në Shqipëri”



Kingdom of the Netherlands

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

Hyrje

Që prej 25 dhjetorit kanë nisur efektin e tyre dispozitat e reja të Kodit Zgjedhor, të cilat parashikojnë ndalimin e veprimtarive publike dhe përdorimit të burimeve shtetërore në një periudhë 4 mujore deri në zgjedhjet për Kuvend. Këto kufizime synojnë krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime partiake.

Kufizimi i burimeve shtetërore në zgjedhje ishte pjesë e marrëveshjes së 5 qershorit 2020 të aktorëve kryesorë politikë në vend të

përfshirë në reformën zgjedhore, si një nga kërkesat kryesore të opozitës, por edhe për të adresuar rekomandimet e [raportit të fundit](#) të Misionit të Vëzhgimit të OSBE-ODIHR. Kjo marrëveshje, e materializuar me miratimin më 23 korrik 2020 të ndryshimeve në “[Kodi Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë](#)”, u përshëndet gjerësisht nga faktori ndërkombëtar, duke e cilësuar si një kusht i rëndësishëm për hapjen e negociatave të pranimit të Shqipërisë me Bashkimin Evropian.

Në kuadër të ndalimit të përdorimit të burimeve shtetërore në fushatën zgjedhore, dispozita e reja në Kodin Zgjedhor parashikojnë:

| Neni | Pika | Dispozita të reja |
|---------|--------|---|
| Neni 91 | Pika 1 | Nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia |
| | Pika 3 | Gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përlligjura. |
| | Pika 4 | Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore |
| Neni 92 | Pika 1 | Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre. |
| | Pika 3 | Raportimi sipas pikës 1 të këtij neni kryhet nëpërmjet ndërfaqes për raportimin e veprimtarive publike, e cila mbahet dhe administrohet nga KQZ-ja. (Detajuar në nenin 92/5) |
| | Pika 5 | Veprimtaritë e ndaluara nga KQZ-ja nuk lejohet të transmetohen apo të pasqyrohen në rubrikat e lajmeve apo ato që mbulojnë fushatën në radio dhe televizione. Transmetimi ose pasqyrimi i tyre në kundërshtim me këtë pikë ngarkon me përgjegjësi sipas këtij ligji transmetuesin radioteleviziv. |

Ky raport pasqyron gjetjet e monitorimit dy javor të zbatimit të këtyre dispozitave të reja të Kodit Zgjedhor, në drejtim të:

- Kuadrit ligjor dhe organizimit institucional për zbatimin e dispozitave;
- Procesin e raportimit dhe kontrollit të veprimtarive të ndaluara nga KQZ;
- Aktet ligjore pjesë e ndalimeve të parashikara në periudhën 4 mujore para zgjedhjeve.

Organizimi institucional për zbatimin e dispozitave

Kodi Zgjedhor ngarkon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për normimin, kontrollin dhe marrjen e masave për parandalimin e përdorimit të burimeve shtetërore në periudhën 4 mujore para zgjedhjeve. Bazuar mbi këto kompetenca, u hartua projektvendimi “Rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Projektvendimi u nda për konsultim më 15 dhjetor 2020 me partitë politike, dhe organizatat jofitimprurëse me objekt të veprimtarisë së tyre të drejtat e njeriut, mirëqeverisjen dhe demokratizimin. Si rrjedhojë e këtij procesi u dorëzuan gjashtë rekomandime nga shoqëria civile dhe katër komente nga Partia Socialiste, e cila shprehu shqetësimin që kufizimet e përcaktuara në projektvendim ... “*mund të cënonin liritë dhe të drejtat politike të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”. Ky qëndrim, që binte ndesh me dakordësinë e marrëveshjes së 5 qershorit mes forcave politike ku bënte pjesë edhe PS, u argumentua si i pabazë në relacionin final që shoqëroi projektvendimin për miratim.

Drafti final duhet theksuar se përfshiu pjesën më të madhe të rekomandimeve të dorëzuara nga shoqëria civile (5 nga 6 rekomandimet) dhe rrëzoi objeksionet e dorëzuara nga PS.

Ndërkohë, në projektvendim u përcaktua një detaj që do të përbënte thelbin e diskutimeve të mëposhme për veprimtaritë e denoncuara si të ndaluara. Në interpretimin e Nenit 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor:

“Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohej propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensione, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore”...

hartuesit e vendimit, përfshinë një korelacion mes veprimtarive të ndaluara dhe periudhës së fondeve të vendosura në dispozicion për to. Në nenin 3, pika 1.1 të projekt-vendimit u detajua si më poshtë koncepti “financim rishtazi”:

“veprimtari të ndaluara” janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi në dispozicion apo transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve”...

Ky përcaktim që kaloi pa diskutime edhe nga përfaqësuesit e opozitës në Komisionin Rregullator, përjashtoi de facto nga penalizimi të gjitha veprimtaritë publike (vizita në investime infrastrukturore, shtëpitë e rikonstruktura nga tërmeti etj) të zhvilluara nga drejtuesit qendrorë dhe vendorë në periudhën nën monitorim nga ky raport.

Ndërkohë, ky interpretim i lehtësuar i ndalimit drastik të cdo aktiviteti publik të zyrtarëve të lartë gjatë katër muajve para zgjedhjeve, krijoi mospërputhje me pritshmëritë e subjekteve politike opozitare dhe publikut gjatë këtyre javëve të para të nisjes së efekteve të dispozi-

tave për ndalimin e burimeve shtetërore, gjë që u reflektua edhe në denoncimet e mbërritura në ndërfaqen për raportimet të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Më 24 dhjetor 2020, projekt-vendimi u paraqit për diskutim në Komisionin Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe u miratua pa ndryshime [në përmbajtje](#),¹ por vetëm me disa sqarime të mëtejshme për të lehtësuar kuptimin më të mirë të ndalimeve të parashikuara.

Kufizimet e veprimtarive publike filluan efektin e tyre vetëm një ditë më pas, më 25 dhjetor 2020 (4 muaj para 25 prilli 2021) duke e bërë të pamundur informimin paraprak të institucioneve dhe zyrtarëve subjekt i ligjit për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. Kjo mungesë informimi dhe detajimi të mëtejshëm të veprimtarive të ndaluara në ditët e para të fillimit të periudhës 4 mujore të kufizimit, e shoqëruara edhe me periudhën e festave të fundvitit (deri më 5 janar 2021), **ngjalli perceptime jo të drejta nga të gjitha palët**. Në media, por edhe më konkretisht në një deklaratë të mëvonshme publike të kryetarit të bashkisë Tiranë, Z. Erion Veliaj, më datë 7 janar 2021, [u kërkua qartësi](#) për kufizimet dhe u aludua për përdorim të qëllimshëm të KQZ nga opozita.

Duhet theksuar se KQZ bëri të mundur ndërtimin e ndërfaqes të parashikuar për raportimet e veprimtarive publike (<https://aktivitete.kqz.gov.al/>) dhe vënien në funksion të saj në kohën e duhur. Raportimet e institucioneve qendrore dhe vendore, të cilat filluan prej datës 27 dhjetor dhe në vijim, janë të publikuara dhe të aksesueshme nga i gjithë publiku. Ndërkohë, struktura e posaçme e ngritur nga KQZ monitoron dhe administron në kohë reale çdo informacion të raportuar. Në rastet kur KQZ merr vendim për të ndaluar zhvillimin e ndonjë veprimtarie, kjo veprimtari klasifikohet tek aktivitetet e ndaluara për t'u zhvilluar. Në ndërfaqen "Veprimtari të ndaluara" janë regjistruar 201 institucione publike qendrore dhe vendore, si edhe agjenci/ndërmarrje

¹ Vendimi nr.9, date 24.12.2020 i Komisionit Rregullator

shtetërore. Deri më 11 janar 2020 [raportohet nga KQZ](#) se personat përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve kanë raportuar për 119 aktivitete të planifikuara për t'u zhvilluar nga ana e tyre.

Gjithashtu në këtë datë figuronin të regjistruara nga kjo ndërfaqe kallëzime për 20 aktivitete të ndaluara, të kryera nga një individ dhe dy organizata. Së fundi, pas sugjerimeve të mbërritura nga shoqëria civile, gjenden të publikuara në ndërfaqe të identifikuar edhe denoncimet për veprimtari të ndaluara nga subjekte politike, organizata apo edhe qytetarë të ndryshëm.

Pavarësisht nisjes së procesit të raportimeve pranë KQZ, subjektet politike opozitare Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim, vendosën të ndjekin një rrugë alternative për të denoncuar veprimtaritë e ndaluara të zyrtarëve të lartë. Më datë 6 janar 2021, PD iu drejtua Prokurorisë Speciale Antikorrupsion SPAK me një kallzim për 16 drejtues qendrorë dhe vendorë (5 anëtarë të Këshillit të Ministrave, 2 deputetë, 7 kryetarë bashkie, 1 drejtor i agjencie publike dhe një administrator vendor), të akuzuar për "Shpërdorim detyre" dhe "Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore". Pak ditë më pas, të njëjtën rrugë për kallzim penal pranë SPAK ndoqi edhe LSI.

Rasti i parë i një procedimi administrativ ndaj një denoncimi në ndërfaqen e KQZ nisi më 11 janar 2021, ndaj drejtorit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lushnjë, bazuar mbi kallzimin për postimin më datë 27 dhe 29 dhjetor 2020 nga deputeti Bujar Çela në rrjetin e tij social të dorëzimit të lejeve të legalizimit të shtëpive të banorëve në Hysgjokaj dhe Golem. KQZ argumentoi se deputetët nuk janë subjekt i kufizimeve të zyrtarëve të lartë pjesë e kufizimeve ligjore dhe si rrjedhojë vendosi të procedojë vetëm drejtorin e Kadastrës që kishte lejuar shpërndarjen e dokumentacionit zyrtar jashtë ambjenteve të institucionit.

Masa administrative e vendosur ndaj

drejtuesit të Kadastrës të gjendur fajtor për këtë shkelje, prej vetëm 1.500 lekë të reja, ishte sidoqoftë tepër simbolike për të ngjallur një efekt të duhur në publikun e gjerë për funksionimin e duhur të procesit dhe ndalimin e veprimeve të ndaluara nga zyrtarët.

Monitorimi I Akteve Normative

Në funksion të Nenin 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor, janë monitoruar Aktet Normative dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave, të cilët janë botuar në Fletoren Zyrtare për periudhën **24.12.2020- 08.01.2021**.

Rezultojnë se mund të konsiderohen si vendime në shkelje të Kodit Zgjedhor:

- 3 Vendime të Këshillit të Ministrave
- 1 akt normativ
- 5 akte ligjore

të cilat sjellin **përfitime apo masa lehtësuese** për periudhën katër mujore para zgjedhjeve. Gjithashtu, **tre akte ligjore** të lidhura me Tatimin mbi të Ardhurat, Tatimin mbi Vlerën e Shtuar dhe Taksat Vendore, të cilat filluan të zbatohen nga data 1 janar 2021 (brenda periudhës 4 mujore) mund të konsiderohen si akte të cilat mund të krijojnë përfitime elektorale me ndikim të gjerë.

Më poshtë po rendisim aktet e konstatuara:

1. Fletore Zyrtare Nr. 228, datë 24.12.2020;

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1044, datë 18.12.2020 Për një shtesë në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar.

Në lidhje me VKM në fjalë, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin që parashikon se mjekët dhe punonjësit e policisë së shtetit do të përfitojnë shpërblimin e fundvitit, mënyra e pagesës së të cilëve përcaktohet, përkatësisht, nga Fondi i Sigurimit të

Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

2. Fletore Zyrtare Nr. 233, datë 30.12.2020;

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1076, datë 24.12.2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e Forcave të Armatosura”, të ndryshuar.

Ky vendim i Këshillit të Ministrave ka ndryshuar strukturën dhe nivelin e pagave të një kategorie të caktuar punonjësish si:

- të punonjësve të personelit mjekësor,
- të punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës.

Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, hyjnë në fuqi nga data 01.01.2021.

3. Fletore Zyrtare Nr. 1, datë 05.01.2021;

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1106, datë 24.12.2020 “Për trajtimin financiar të mentorit në Shërbimin Informativ të Shtetit” dhe **Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1113, datë 24.12.2020** “Për masën dhe mënyrën e kompensimit të udhëtimit, të qirasë së banesës dhe rimbursimit të shpenzimeve të transferimit për punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit”.

- Këto vendime të Këshillit të Ministrave kanë vendosur të shtojnë një trajtim financiar për një kategori punonjësish në Shërbimin Informativ të Shtetit. Ky trajtim financiar jepet në formën e një page apo

të një shpërblimi. Gjithashtu trajtohen një numër i caktuar punonjësish të SHISH, të cilët përfitojnë pagesë për kompensime udhëtimi dhe qiraje në rast transferimi jashtë vendbanimit.

4. Fletore Zyrtare Nr. 2, datë 07.01.2021;

Akt Normativ nr. 36, datë 23.12.2020 “Për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së Certifikatës së Kontrollit teknik”.

- Ky Akt Normativ i Këshillit të Ministrave ka zgatur afatin e vlefshmërisë së Certifikatës së Kontrollit Teknik të mjeteve me motor (Kolaudimi i Makinave) për një periudhë prej 3 muajsh. Ky vendim përbën në vetvete një aministi apo falje detyrimesh dhe përfitim për atë kategori të caktuar individësh apo shoqërisht të cilët kanë në përdorim një automjet dhe ligjërohen të qarkullojnë lirshëm pa një akt kolaudimi makine.

5. Fletore Zyrtare Nr. 3, datë 08.01.2021;

Ligj nr. 156/2020 “Për faljen e detyrimeve të Ushtarakëve ndaj Fondit të Sigurimeve Shoqërore, të krijuara si diferencë nga rishqyrtimi i pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, të caktuara sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bazuar në kriteret e Vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr. 3, datë 24.11.2016”. Dekretuar nga Presidenti i Republikës; **Nr.Dekretit 11896**, Tiranë më 05.01.2021.

- Ky ligj përbën në vetvete një aministi apo falje detyrimesh dhe përfitim për atë kategori të caktuar individësh, ushtarakë të cilët kanë përfituar pensione të parakohshme ushtarake për vjetërsi shërbimi në një masë më të madhe sa ka përcëkatuar ligji duke krijuar kështu një detyrim ndaj Fondit të Sigurimeve Shoqërore

6. Fletore Zyrtare Nr. 3, datë 08.01.2021;

Ligji Nr. 164/2020 për disa ndryshime në ligjin nr. 90/2019 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”, i ndryshuar”. Dekretuar nga Presidenti i Republikës; **Nr.Dekretit 11900**,

Tiranë më 05.01.2021.

- Ky ligj hyn në fuqi në datën 23.01.2021 dhe i shtrin efektet deri në datën 31.12.2021. Sa më sipër është shtyrë afati i rivlerësimit të pësuarive të paluajtshme afat i cili ka qënë deri në datën 31.12.2021. Sipas këtij ligji është ulur baza e tatimit fitimit nga 15% në 3% për pasuritë e paluajtshme në pronësi të individëve (individit duhet të paguajë më parë tatimin e rivlerësimit (**3% e bazës së tatueshme**) dhe tarifën e shërbimit) dhe 5% në pronësi të Subjekteve Tregtare.

7. Fletore Zyrtare Nr. 3, datë 08.01.2021;

Ligj nr. 165/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9179, datë 29.01.2004, “Për një trajtim të vecantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarje të industrisë ushtarake” të ndryshuar. - Dekretuar nga Presidenti i Republikës; **Nr.Dekretit 11901**, Tiranë më 05.01.2021.

- Nëpërmjet këtij ndryshimi, përfitojnë trajtim të një kategori e caktuar punonjësish të ish-Ndërmarrjeve Ushtarake.

8. Fletore Zyrtare Nr. 3, datë 08.01.2021;

Ligj nr. 167/2020 Për faljen e detyrimeve të Sigurimeve Shoqërore, që ish-punonjësit e nëntokës kanë ndaj institutit të sigurimeve shoqërore, të llogaritura për periudhën që kanë përfituar sipas ligjit nr. 8685, datë 09.11.2000, “Për një trajtim të vecantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëtokë”, të ndryshuar të cilët njëkohësisht kanë zhvilluar aktivitet ekonomik si të punësuar ose të vetëpunësuar. - Dekretuar nga Presidenti i Republikës; **Nr.Dekretit 11902**, Tiranë më 05.01.2021.

- Ky ligj parashikon faljen e detyrimeve të papaguara të ish-punonjësve të nëntokës ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për disa përfitime të pëfituara sipas ligjit 8685/2000. Ky ligj përbën në vetvete një aministi, falje gjobash dhe detyrimesh të vendosura ndaj ish-punonjësve të nëntokës nga ana e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

9. Fletore Zyrtare Nr. 3, datë 08.01.2021;

Ligj nr. 169/2020 “Për Njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore”. - Dekretuar nga Presidenti i Republikës; **Nr.Dekretit 11903**, Tiranë më 05.01.2021.

- Ky ligj parashikon njohjen si periudha sigurimi **për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore** kohën e punësimit në ish-kooperativat bujqësore për ato ish-kooperativa bujqësore për të cilat nuk disponohet dokumentacioni i vjetërsisë në punë.

Përveç akteve të mësipërme të nxjerra nga Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi, rezulton se gjatë periudhës Korrik 2020- Nentor 2020 janë miratuar akte të cilat kanë bërë ndryshime të rëndësishme në legjislacionin shqiptar që lidhet me Tatimin mbi të Ardhurat, Tatimin mbi Vlerën e Shtuar dhe Taksat Vendore, të cilat filluan të zbatohen nga 1 janari 2021. Në thelb këto akte që parashikojnë uljen ose heqjen e taksave me një ndikim të madh në buxhetin e shtetit, për një pjesë të madhe të bizneseve në Shqipëri mund të konsiderohen si **akte të cilat mund të krijojnë përfitime elektorale** me ndikim të gjerë.

Më konkretisht:

- Fletore Zyrtare Nr. 154, datë 26.08.2020; **Ligj nr. 106/2020** Për disa ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar.
 - Ky ligj parashikon se tatimpaguesit me të ardhura vjetore deri në 14 milion lekë në viti do të taten me 0%. Më parë për këtë kategori tatimpaguesish është aplikuar norma 5%.
 - Shkalla e tatimit mbi fitimin për tatimpaguesit me të ardhura vjetore mbi 14 milion lekë mbetet 15%.

Megjithëse ky ligj ka hyrë në fuqi në datën 10 shtator 2020, konstatohet se efektet e tij fillojnë nga data 01.01.2021.

- Fletore Zyrtare Nr. 139, datë 29.07.2020;

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 576, datë 22.07.2020 Për disa ndryshime në Vendimin nr. 953, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

- Ky vendim parashikon se kufiri minimal i regjistrimit për TVSH është qarkullimi vjetor prej 10 milion lekësh nga 2 milionë lekë që ishte. Pragu i ri i TVSH-së do të zbatohet në mënyrë uniforme për të gjitha kategoritë e tatimpaguesve. Megjithëse ky vendim ka hyrë në fuqi në datën 29 Korrik 2020, konstatohet se efektet e tij fillojnë nga data 01.01.2021.

- Fletore Zyrtare Nr. 197, datë 12.11.2020; **Ligji nr. 122/2020** Për disa ndryshime në ligjin nr. 9539632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar.

- Ky vendim ligj parashikon se tatimpaguesit e regjistruar që kryejnë një aktivitet biznesi dhe që kanë një xhiro vjetore në interval nga 0-8 milion lekë, do të nënshtrohen taksës së thjeshtuar të biznesit të vogël dhe duke filluar nga 01 Janari 2021 kjo taksë për këtë kategori do të jetë me normën 0%.
- Më parë tatimpaguesit që kishin një qarkullim vjetor nga 0-5 milion lekë ishin subjekt i taksës me normë 0%, ndërsa tatimpaguesit me qarkullim vjetor prej 5 milion deri në 8 milion lekë ishin subjekt i taksës me normën 5%. Pra për këtë fashë konstatohet ulje taksash.

Megjithëse ky vendim ka hyrë në fuqi në datën 27 Nëntor 2020, konstatohet se efektet e tij fillojnë nga data 01.01.2021.

Rekomandime

- ❖ Në përgjigje edhe të interesit të vetë zyrtarëve që janë subjekti kufizimeve është e nevojshme që të zhvillohet dhe bëhet publik nga KQZ detajimi i mëtejshëm i veprimtarive të ndaluara publike, me shembuj praktikë. Informimi i duhur do të ndihmojë krijimin e besimit të duhur të aktorëve politikë në funksionimin e procesit dhe vetë kompetencat e KQZ.
 - ❖ Hartimi i një fushatë informuese për institucionet dhe publikun e gjerë do të ndihmojë të gjithë aktorët që të njohin më mirë kufizimet e parashikuar gjatë periudhës 4 mujore si dhe nxisë kallzimet e mëtejshme nga publiku. Inkurajohet të nxitet interesi publik nëpërmjet Medias, për të promovuar problematikat që lidhen më përdorimin e burimeve shtetërore në fushatë elektorale, duke denoncuar dhe raste konkrete në ndërfaqen e KQZ-së.
 - ❖ KQZ duhet të ndërtojë një procesim më efikas dhe institucional për ndjekjen dhe vendimmarrjen ndaj rasteve të denoncuar ndaj zyrtarëve të lartë shtetërore.
 - ❖ Subjektet politike dhe institucionet publike të përfshira në rastet e denoncuar dhe proceduara nga KQZ për shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor, duhet të ndërmarrin procedura administrative ndaj përfaqësuesve të tyre politikë si dhe drejtuesve të strukturës, për të krijuar praktika për distancimin nga këto veprime antiligjore në të ardhmen.
- Në përfundim, apelojmë të zgjedhurit politikë dhe zyrtarët e lartë subjekt i këtyre kufizimeve që të respektojnë zotimin për një lojë të ndershme gjatë këtyre muajve të mbetur deri në 25 prill, në respekt të një standarti të premtuar dhe shumëpritur nga qytetarët për të mundësuar zgjedhje të lira dhe të ndershme.

**Hartoi raportin:
Isuf Shehu - Gerta Meta**